



## KOMUNA E PRISHTINËS

### RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Kadastrit
Periudha raportuese	Qershor 2018
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Nora Kelmendi, drejtoreshë e Drejtorisë së Kadastrit

#### **1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.**

Drejtoria e Kadastrit - Zyra kadastrale komunale (ZKK) e Prishtinës, ka vazhduar të bëjë ofrimin e shërbimeve sa më efikase për qytetarë, duke ofruar informacione dhe të dhëna të azhuruara për pronat e paluajtshme.

Gjatë muajit **qershor 2018**, në **6** zyrat pritëse janë pranuar gjithsej **4,011** kërkesa, nga të cilat janë miratuar **3,774** kërkesa, refuzuar **27** kërkesa dhe kanë mbetur në procedurë edhe **116** kërkesa, të cilat janë realizuar përmes **2 sektorëve**: Sektorit të kadastrit dhe Sektorit të gjeodezisë.

#### **2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me planprogramin e Komunës për drejtorinë tuaj.**

Aktivitetet e planifikuara të Drejtorisë së Kadastrit janë:

- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të pronësisë;
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim dhe çregjistrim të hipotekës;
- Shqyrtimi i kërkesave për përmirësim të regjistrave kadastralë;
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të banesave;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve;
- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë, parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënien e produkteve (koordinatave);
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njësisë banesore;
- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe rirregullim kufiri;
- Shqyrtimi i kërkesave nga gjeodetët dhe kompanitë e licencuara;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.

**3. *AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.***

Në Drejtorinë e Kadastrit në Prishtinë gjatë muajit **Qershor 2018**, nëpërmes zyrave pritëse dhe 2 sektorëve, të kadastrit dhe të gjeodezisë, janë pranuar kërkesa të ndryshme, prej të cilave:

**Në sektorin e kadastrit janë përpunuar kërkesat në vijim:**

- 293 kërkesa për regjistrim të pronësisë, prej të cilave janë aprovuar 212, janë refuzuar 13 kërkesa për regjistrim të pronësisë, ndërsa janë njoftuar palët në procedurë me 68 konkluzione, duke u pezulluar procedura deri në plotësimin e lëndëve me dokumentacione përkatëse;
- 10 kërkesa për historik nga persona fizikë, institucione, prej të cilave janë miratuar 7, është refuzuar 1 kërkesë, ndërsa në procedurë kanë mbetur 2;
- 336 shkresa / kërkesa nga institucionet e ndryshme, prej të cilave janë miratuar 297, janë refuzuar 8 dhe në procedurë kanë mbetur edhe 31 kërkesa;
- 16 kërkesa për përmirësime, nga të cilat janë miratuar 9, janë refuzuar 2 dhe 5 janë në procedurë;
- 1 kërkesë për regjistrim të barrës tatimore, e cila është regjistruar;
- 2 kërkesa për lirim të barrës tatimore, të miratuara;
- 72 kërkesa për regjistrim të hipotekave prej të cilave janë miratuar të gjitha dhe 59 kërkesa për çregjistrim hipoteke, prej të cilave janë miratuar 57, dhe 2 janë refuzuar.

**Kërkesa të pranuar për këtë sektor gjatë kësaj periudhe gjithsej kanë qenë - 789, nga të cilat 657 kërkesa janë miratuar, 26 janë refuzuar dhe 106 kërkesa kanë ngelur në procedurë.**

**Në sektorin e gjeodezisë janë përpunuar kërkesat në vijim:**

- 1,750 kërkesa për certifikata të pronësisë dhe 1,205 kërkesa për kopje të planit, në total janë pranuar dhe realizuar;
- 27 kërkesa për ndarje të pronësisë, nga të cilat janë miratuar 25, në procedurë kanë mbetur edhe 2 kërkesa;
- 18 kërkesa për bashkim të parcelave dhe janë miratuar të gjitha;
- 54 kërkesa për dhënien e produkteve (koordinatave), të realizuara të gjitha;
- 73 kërkesa për identifikimin e njësisive banesore, nga të cilat janë miratuar 69 dhe në procedurë kanë mbetur 4;
- 10 kërkesa për përcaktim dhe rirregullim kufiri, nga të cilat janë miratuar 9 dhe në procedurë ka mbetur edhe 1 kërkesë;
- 63 kërkesa nga gjeodetët dhe kompanitë e licencuara, nga të cilat janë miratuar 59, 1 kërkesë e refuzuar dhe në procedurë kanë mbetur edhe 3 kërkesa;
- 22 kërkesa zyrtare për përmirësime nga palët dhe kërkesa zyrtare nga institucionet si: Ministria e Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Urbanizimit, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Agjencia Kosovare e Pronës (KPA), Ndërmarrja Publike Banesore dhe të cilat janë aprovuar në tërësi.

**Numri i kërkesave të pranuar për këtë sektor ka qenë - 3,222, nga të cilat janë miratuar 3,117 kërkesa, është refuzuar 1 kërkesë dhe 10 kanë ngelur në procedurë.**

Nga të dhënat e lartshënuara shihet se Drejtoria e Kadastrit ka implementuar gati **97** për qind (%) të planit të saj, duke i miratuar, refuzuar ose pezulluar kërkesat e palëve në procedurë, sipas shqyrtimeve ligjore që ka bërë lidhur me këto kërkesa.

E arritur e kësaj Drejtorie është që në afatin e përcaktuar ligjor prej 15 ditëve, ka arritur të nxjerrë vendime meritore për secilën prej kërkesave të parashtruara nga palët /subjektet juridike.

**4. *AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.***

Aktivitetet që janë në implementim e sipër nga Sektori i kadastrit:

- Lëndët në shpallje publike në afat prej **5** ditë pune, që kanë të bëjnë me regjistrimin e pronës së paluajtshme në operatin kadastral;
- Lëndët e dërguara në KPA, verifikim dhe pëlqime për regjistrim të banesave;
- Lëndët e dërguara për verifikim në gjykata, Arkiv Komunal ose Ndërkomunal;

Aktivitetet që janë në implementim e sipër nga Sektori i gjeodezisë:

- Lëndët për ndarje, identifikim dhe bashkim të parcelave;
- Lëndët për identifikimin e njësive banesore;
- Lëndët për kërkesa zyrtare dhe kërkesa nga institucionet.

**4.1.1. STATISTIKAT-Të listohen te gjitha statistikat perkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të këtë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.**

<b>Kërkesat e pranuar në Drejtorinë e Kadastrit, qershore 2018</b>	<b>Numri i përgjithshëm i kërkesave</b>	<b>Të miratuara</b>	<b>Të refuzuara</b>	<b>Në procedurë</b>	<b>Mjetet e grumbulluara €</b>
Certifikata të pronësisë dhe kopje të planit	<b>2,955</b>	<b>2,955</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>14,330</b>
Kërkesa për RDPP (regjistrimi i të drejtës për pronë të paluajtshme)	<b>293</b>	<b>212</b>	<b>13</b>	<b>68</b>	<b>10,146</b>
Kërkesa për historik zyrtarë, historik për persona fizikë dhe juridikë	<b>10</b>	<b>7</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>150</b>
Kërkesa nga institucionet e ndryshme dhe përgjigjet nga Gjykata dhe institucione të tjera - Shërbimi i RDPP-së	<b>336</b>	<b>297</b>	<b>8</b>	<b>31</b>	<b>410</b>
Përmirësime në RDPP	<b>16</b>	<b>9</b>	<b>2</b>	<b>5</b>	<b>320</b>
Vendosje të barrës tatimore	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>30</b>
Lirim nga barra tatimore	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>20</b>
Kërkesat për regjistrim të hipotekave	<b>72</b>	<b>72</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>9,200</b>
Kërkesat për çregjistrim të hipotekave dhe ndryshime	<b>59</b>	<b>57</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>590</b>
Ndarjet - parcelimet	<b>27</b>	<b>25</b>	<b>0</b>	<b>2</b>	<b>2,660</b>
Bashkimi i parcelave	<b>18</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>3,100</b>
Dhënia e produkteve - pikave kadastrale (koordinatave)	<b>54</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1,060</b>
Identifikimi i parcelave dhe njësive banesore	<b>73</b>	<b>69</b>	<b>0</b>	<b>4</b>	<b>2,434</b>
Përcaktimi dhe rirregullimi i kufirit të parcelave	<b>10</b>	<b>9</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>1,480</b>
Kërkesat me licencë	<b>63</b>	<b>59</b>	<b>1</b>	<b>3</b>	<b>8,525</b>
Kërkesa zyrtare nga institucionet - Shërbimi i gjeodezisë	<b>22</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>120</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>4,011</b>	<b>3,774</b>	<b>27</b>	<b>116</b>	<b>54,575</b>

#### 4.1.2 *Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese*

Drejtoria e Kadastrit nuk shpenzon buxhet për të regjistruar të drejtat pronësore në regjistrat kadastral, përkundrazi, kjo drejtori realizon të hyra nga taksat e qytetarëve.

#### 4.1.3 *Takimet me palë*

- **Sektori i kadastrit**, gjegjësisht Zyra për regjistrimin e pronës së paluajtshme (RDPP), ka takime të rregullta me palë dy herë në javë ( *të martave dhe të enjteve*), nga 2 orë në ditë me dy zyrtarë ligjorë, ku ofrohen këshilla për plotësim të lëndëve sipas kërkesave të palës. Brenda këtyre 2 ditëve, 2 zyrtarët e Zyrës për RDPP takohen me rreth 413 qytetarë.
- **Sektori i gjeodezisë** ka takime të rregullta me palë një herë në javë (të mërkurave) nga 2 orë, ku gjatë muajit qershor ka pranuar 365 palë për plotësim të lëndëve sipas kërkesave të tyre për ndarje, bashkim ose rregullim kufiri. Po ashtu, ka takime me palë për identifikimin e banesave, si dhe takime të tjera me palë sipas kërkesave të tyre lidhur me çështjet pronësore.

#### 5. *Takimet me institucione të tjera*

- **Sektori i kadastrit** ka pasur takim me qytetarë për çështje të ndryshme kadastrale pronësore, për të cilat kemi zgjidhje ligjore, ose i kemi udhëzuar palët që t’u drejtohen institucioneve tjera në vend. Takim me Policinë e Kosovës, zyrtarë të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, etj., lidhur me lëndët në procedurë dhe çështje tjera.

5.1.1 *Diskutime publike/takimet me qytetarë* - Nuk kemi pasur.

#### 6. *Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare*

6.1.1 *Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër*

- **Sektori i kadastrit:**

- Lëndë të pranuar: **789**
- Lëndë të miratuara: **657**
- Lëndë të refuzuara: **26**
- Lëndë në procedurë: **106**

- **Sektori i gjeodezisë:**

- Lëndë të pranuar: **3,222**
- Lëndë të miratuara: **3,117**
- Lëndë të refuzuara: **1**
- Lëndë në procedurë: **10**

*Takime të tjera* - nuk kemi pasur.

7. **SFIDAT** - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës, apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.

**Spektori i kadastrit:**

- Sfidues është komunikimi me institucionet, mosdhënien e përgjigjeve në afat ligjor, të cilat na krijojnë probleme me palë dhe përfaqësues të palëve;
- 7 kërkesa presin për verifikim në Arkivin Komunal dhe Ndërkomunal;
- 46 kërkesa presin për verifikim në Gjykatë;
- 4 kërkesa presin për verifikim në privatizim;
- 7 kërkesa presin për verifikim në NPB;
- 7 kërkesa presin për verifikime në KPA.

**Spektori i gjeodezisë:**

- Sfidues është komunikimi me Agjencinë Kadastrale të Kosovës, mosdhënia e përgjigjeve në lidhje me problemet që hasim çdo ditë me programin **Harta Kadastrale** dhe **SIKTK**, të cilat na krijojnë probleme me palë dhe përfaqësues të palëve.
- Mungesa e shënimeve në pjesën grafike, gabimet të cilat janë krijuar me rastin e rikonstruktimit të disa zonave kadastrale nga **Agjencia Kadastral e Kosovës**.

8. **REKOMANDIME** - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtoreve, furnizim me pajisje shtesë etj.

**Spektori i kadastrit:**

- Trajnime për punëtore sa i përket administratës dhe funksionimit të saj.

**Spektori i gjeodezisë:**

- Trajnime për punëtore.

**9. *AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES -Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues.***

**Spektori i kadastrit:**

- Lëndët në shpallje publike në afat prej 5 ditë pune;
- Lëndët në KPA për pëlqime për regjistrim të banesave;
- Lëndët për verifikim në gjykata, NPB, AKP, Arkiv Komunal ose Ndërkomunal.

**Spektori i gjeodezisë:**

- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë;
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënien e produkteve (koordinatave);
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njësisve banesore;
- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe rirregullim kufiri;
- Shqyrtimi i kërkesave për gjeodetë apo kompani të licencuara;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.

**10. *TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.***

- Takimi i mbajtur me kryeshefin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe dakordimi i arritur që të fillohet me projektin e printimit të certifikatave të pronës dhe kopjeve të planit, përmes 5 (pesë) E-kiosqeve në rajonin e Prishtinës.